
Mallakaster, më 13/04/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA MALLAKASTËR

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale, Neni 248 "Shpërdorimi detyrës"
Neni 328 "Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve".

KUNDER:

DREJTUAR: PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
FIER

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 , si dhe neneve 248 e 328 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtuar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, dhe 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.